



Funded by  
the European Union



# BE për Përfshirje në Tregun e Punës

## Thirrje për Projekt Propozime

Sesioni informues I, 27 Gusht 2024 Webinar  
Sesioni informues II, 29 Gusht 2024, Webinar  
Sesioni Informues III, 4 Shtator 2024, Europe House, Tiranë



“

Forcimi i partneritetit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) me bashkitë për të ofruar punësim **gjithëpërfshirës dhe të integruar**, si dhe për të mundësuar **zhvillimin e aftësive për grupet vulnerabël**, në bashkëpunim me aktorët e tregut të punës.

— Ndikimi

”

BE për **Përfshirje në  
Tregun e Punës**

# SKEDA E PROGRAMIT

## Buxheti

3 000 000 euro

(90% kontribut i BE-së dhe  
10% kontribut i UNDP-së)

## Afati Kohor

18.12.2023-17.12.2026  
(36 muaj)

## Përfituesit


1. Grupi i synuar,
2. stafi i AKPA-s,
3. Punonjësit e bashkisë dhe shërbimit social,
4. OJF-të,
5. sektori privat,
6. ofruesit e AFP-së.

## Partnerët

1. UNDP në Shqipëri
2. Shërbimi Publik Suedez i Punësimit (Arbetsförmedlingen)
3. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizua (FShDPAK)

## Grupi i synuar

1. NEET (15-29 vjeç jo në punësim, arsim apo trajnim)
2. Nënata e reja,
3. Përfituesit e ndihmës ekonomike,
4. Personat me aftësi të kufizuara



## Bashkitë e synuara (19 bashki)

Prrenjas, Gjirokastrë,  
Vorë, Mallakastër,  
Cërrik, Librazhd, Shijak,  
Kavajë, Kurbin, Kukës,  
Krujë, Pogradec, Korçë,  
Kamëz, Vlorë, Shkodër,  
Elbasan, Durrës, Tiranë.

# REZULTATET

1

Nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar të punësimit për grupet e riskut, gratë dhe burrat, si dhe djemtë dhe vajzat, në përputhje me nevojat e tregut rajonal të punës.

2

Përmirësimi i aksesit dhe fleksibilitetit të ofertës së zhvillimit të aftësive për të rinjtë dhe të rriturit me kualifikime të ulëta nga grupet e riskut.

3

Promovimi dhe ofrimi i modeleve të aksesueshme dhe novatore të punësimit me mbështetje dhe zhvillimit të aftësive për personat me aftësi të kufizuara

# KONSOLIDIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA

Vlerësime të shpejta të hendeqeve aktuale në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe zhvillimin e aftësive

Mbështetja e konsolidimit të praktikave të testuara të menaxhimit të integruar të rastit nga ZP-të nëpërmjet shërbimeve sociale bashkiake dhe aktorëve të tjerë


Projektimi i instrumenteve për shërbimet orientuese dhe këshilluese profesionale nga ZP-të dhe ofruesit e AFP-së.

Organizimi i panairove të punës dhe aftësive në nivel rajonal për të promovuar mundësitë për karrierë profesionale

# SHKËMBIMET DHE MËSIMET ME SHËRBIMIN PUBLIK SUEDEZ TË PUNËSIMIT

Konsolidimi dhe  
përshkallëzimi i orientimit  
dhe këshillimit profesional

Përmirësimi i këshillimit  
intensiv dhe qasjeve për  
menaxhimin e integruar  
të rastit



Dizenjimi i modeleve të  
punësimit me mbështetje  
dhe zhvillimit të aftësive për  
personat me aftësi të  
kufizuar.

# AKTIVITETET QË SYNOJNË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, NË PARTNERITET ME ADRF

- **Aktivite për informimin e komunitetit për të promovuar jetesën aktive dhe punësimin me mbështetje** (duke përfshirë këshillues dhe mentorë) për personat me aftësi të kufizuara, duke e vënë theksin veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë, si dhe duke synuar punëdhënësit, institucionet përgjegjëse për zhvillimin e aftësive dhe sektorin publik
- **Kontrollet e aksesueshmërisë dhe ofrimi i ndërhyrjeve në infrastrukturën e shërbimeve** (të butë) të pesë zyrave të punësimit (pikat e ofrimit të shërbimit të Shërbimit Publik Suedez të Punësimit), bazuar te modeli i zhvilluar në ZP-në e Tiranës (në mjediset e Qendrës së Formimit Profesional 4 në Tiranë).
- **Mbështetje për zbatimin e vlerësimit të performancës në punë të personave me aftësi të kufizuara**, sistemimin në punë, punëdhënësit, profesionistët e rehabilitimit, mësuesit e AFP-së, instruktorët e trajnimit dhe individët me aftësi të kufizuara.

# Prezantim i Qëllimit dhe Lot-eve të Thirrjes për Propozime



# Objektivi i Përgjithshëm i Thirrjes për Projekte

*«të forcojë modelet gjithëpërfshirëse të aktivizimit në punësim dhe zhvillim të aftësive në 19 bashkitë e synuara, duke përshkallëzuar modelet ekzistuese të programeve aktive të tregut të punës dhe programeve të zhvillimit të aftësive.»*

# Grupet e synuara

## NEET

*Të rinj 15-29, jo në punësim, arsim ose trajnim*, përkufizohet si të rinj të moshës 15-29 vjeç që plotëson një nga kushtet, përcaktuara në **Ligjin nr. 15/2019 për Nxitjen e Punësimit**.

## Nënat e reja

**Nënat e reja të papuna** përkufizuar si nëna nën moshën 18 vjeç, të cilat janë gjithashtu kryefamiljare dhe nuk janë të punësuar, përcaktuar në **Ligjin nr. 15/2019 për Nxitjen e Punësimit**.

## Përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike

a) **Familjet në nevojë**, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme. b) **Jetimët** të cilët nuk janë në institucione të përkujdesjes shoqërore. c) **Prindërit me më shumë se dy fëmijë**, të lindur njëherësh që u përkasin familjeve në nevojë. d) **Viktimat e trafikimit** pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre. e) **Viktimat e dhunës në familje** për periudhën e vlefshmërisë së UM ose UMM, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, përcaktuar në **ligjin nr. 57/2019, për Asistencën Sociale**.

## Personat me Aftësi të Kufizuar

**Individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore**, të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe qëndrimore, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët, siç përcaktohet me **ligjin nr. 93/2014, Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për PAK**.


# Grupet e synuara

Të gjithë përfituesit e projektit duhet të jenë

- ✓ Të regjistruar si punëkërkuar të papunë në zyrën përkatëse të punës në bashkinë e synuara;
- ✓ ose duhet të referohen në zyrën përkatëse të punës për t'u regjistruar në momentin e zbatimit të projektit.

Vetëm përfaqësuesit e grupit të synuar, të, mund të kenë të drejtë për mbështetje në cilindo nga tre LOT-et. cilët janë punëkërkuar të papunë të regjistruar

# Mbulimi territorial



Projektet duhet të zhvillohen **në një ose më shumë nga 19 bashki të synuara në Shqipëri.**

| Nr | Rajoni      | Bashkitë                            |
|----|-------------|-------------------------------------|
| 1  | DURRËS      | Durrës, Krujë, Shijak               |
| 2  | ELBASAN     | Elbasan, Librazhd, Cërrik, Prrenjas |
| 3  | FIER        | Mallakastër                         |
| 4  | GJIROKASTËR | Gjirokastër                         |
| 5  | KORÇË       | Korçë, Pogradec                     |
| 6  | KUKËS       | Kukës                               |
| 7  | LEZHË       | Kurbin                              |
| 8  | SHKODËR     | Shkodra                             |
| 9  | TIRANË      | Tiranë, Kavajë, Vorë, Kamëz         |
| 10 | VLORË       | Vlorë                               |

# Lotet e thirrjes

**LOT 1 – Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të këshillimit intensiv për punësimin**

**LOT 2 – Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve cilësore, fleksibël dhe të personalizuar për aftësitë bazë (shkrim-lexim, numerike dhe digjitale)**

**LOT 3 – Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të punësimit me mbështetje dhe zhvillimit të aftësive duke përfshirë trajnerë, këshillues dhe mentorë për PAK**

# LOT I: Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të këshillimit intensiv për punësim

**Objektivi i përgjithshëm:** të mbështesë zhvillimin dhe shtrirjen e programeve të këshillimit intensiv për punësim, ofruar në partneritet me AKPA, organizatat e shoqërisë civile dhe/ose bashkitë.

**Grupi i synuar:** të gjitha (4) grupet e synuara - punëkërkues të papunë të regjistruar në 19 bashki

**Referencë:** Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 401, datë 19.06.2024, i disponueshëm në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/06/19/401/1891acb0-eb8d-43bd-a69b-f9b853efeae6;q=riintegrim%20xintjesocial%20pu> )

# LOT I - Objektivat/Prioritetet Specifike

1. **600 punëkërkues të papunë** përfitojnë nga zbatimi i programeve të Këshillimit Intensiv për Punësim, ofruar përmes projekteve të zhvilluara në këtë LOT.
2. **Përmirësimi i mekanizmit ekzistues** të ofrimit të shërbimeve të integruara për grupet e synuara, nëpërmjet angazhimit të të gjithë aktorëve të tregut të punës në bashkitë përkatëse.
3. **Krijimi dhe ndarja e praktikave dhe të dhënave** nga modelet/projektet e mëparshme pilot në AKPA dhe zyrat e shërbimit të punësimit.
4. **Zgjerimi i modelit të këshillimit intensiv** për punësim në 19 bashkitë e synuara në këtë thirrje.

# LOT I - Llojet e Aktiviteteve (sugjerime)

- Përgatitja dhe zbatimi i **Planeve Individuale të Riintegritit dhe punësimit** për të mbështetur përfituesit e përzgjedhur
- Ofrimi i mbështetjes së personalizuar për zhvillimin individual përmes **aftësive të buta dhe të jetës** (p.sh. trajnime për të rritur zhvillimin personal dhe aftësitë për punësueshmëri për përfituesit (punëkërkuesit e papunë, të regjistruar)
- Ofrimi i seancave të **këshillimit në grup dhe individual** (p.sh. këshillim për punësim dhe zhvillim në karrierë, adresimi i nevojave të shumëfishta të përfituesve etj.)
- Ofrimi i **këshillime të specializuara** për punësim, mentorim për vetëpunësim dhe trajnime profesionale (p.sh. trajnime dhe kurse profesionale, mentorim dhe trajnim për punësim).



# LOT II: Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve cilësore, fleksibël, dhe të personalizuarra për aftësitë bazë (shkrim-lexim, numerike dhe digjitale)

**Qëllimi i përgjithshëm:** të ofrojë trajnime cilësore, fleksibël dhe të personalizuar për të papunët afatgjatë, me nivel të ulët aftësish ose që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm.

**Grupi i synuar:** të gjitha (4) grupet e synuara - punëkërkues të papunë të regjistruar në 19 bashki

**Reference:** AKPA, me mbështetjen e UNDP, ka zhvilluar një model të përshtatur dhe fleksibël mbi aftësitë bazë në shkrim-lexim, numerike, dhe digjitale, për punëkërkuesit e rritur që nuk kanë përfunduar arsimin bazë në Shqipëri, në kuadër të projektit "Mbështetje për Mësimin e Vazhdueshëm për të Papunët", i financuar nga programi i BE-së për Punësimin dhe Inovacionin Social (EaSI). Dokumentacioni i disponueshëm për të gjithë të interesuarit.

# LOT II - Objektivat/Prioritetet Specifike

1. **600 punëkërkes të papunë** përfitojnë nga trajnimet cilësore, fleksibël, të personalizuar për aftësitë bazë (shkrim-lexim, numerike dhe digjitale), ofruar përmes projekteve të zhvilluara në këtë LOT.
2. **Zhvillimi i 'bridge courses'** për të mundësuar akses në formim profesional për individët që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm.
3. **Zbatimi i kurrikulave** të zhvilluara nga projekti SCUL, duke zgjeruar mbulimin, për të përfshirë të papunët afatgjatë.
4. **Forcimi i ofrimit të shërbimeve të integruara** për grupet e cënueshme që përfshijnë orientim dhe këshillim profesional.

# LOT II - Llojet e Aktiviteteve (sugjerime)

- **Ofrimi i trajnimeve për aftësitë bazë** (shkrim-lexim, numerike dhe digjitale (p.sh. kurse për të përmirësuar aftësitë themelore në shkrim-lexim, llogaritje, aftësitë bazë kompjuterike, interneti, etj.)
- Ofrimi i **shërbimeve të këshillimit** për të përmirësuar aftësitë për t'u punësuar (p.sh. mentorim dhe mbështetje për të ndihmuar përfituesit të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për integrim dhe qëndrueshmëri në tregun e punës, etj.)
- Ofrimi i **shërbimeve të referimit dhe menaxhimit të integruar të rasteve** duke adresuar nevojat e shumëfishta të përfituesve etj.
- Ofrimi i **mbështetjes për kërkimin dhe gjetjen e punës**.

## LOT III: Zhvillimi dhe ofrimi i programeve të punësimit me mbështetje dhe zhvillimit të aftësive duke përfshirë trajnerë, këshillues dhe mentorë për PAK

**Qëllimi i përgjithshëm:** të mbështesë ofrimin e programeve të punësimit me mbështetje dhe zhvillimit të aftësive për PAK për aftësim dhe rehabilitim për punë me synim lehtësimin e përfshirjes sociale dhe punësimit.

**Grupi i synuar:** punëkërkues me aftësi të kufizuara në të 19 bashkitë e targetuara.

**Reference:** Amendimet e miratuara së fundmi në Ligjin për Nxitjen e Punësimit (2023), zgjerojnë fushën e programeve të pranueshme për mbështetje financiare përmes Fondit Social të Punësimit, me qëllim lehtësimin e përfshirjes sociale dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

# LOT III - Objektivat/Prioritetet Specifike

- ✓ **200 punëkërkuar me aftësi të kufizuara** punësohen ose marrin aftësim për punë përmes programeve të punësimit me mbështetje dhe zhvillimit të aftësive, duke përfshirë trajnerë, këshillues dhe mentorë, ofruar përmes projekteve të zhvilluar në këtë LOT.
- ✓ **Përshkallëzim i përvojave** të aktorëve në nivel lokalë në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe programeve të zhvillimit të aftësive për personat me aftësi të kufizuara.
- ✓ Zhvillimi i modeleve dhe praktikave të mira për referim në hartimin e programeve e ardhshme që mund të mbështeten nga Fondi Social i Punësimit.
- ✓ Mbështetje e AKPA në strategjitë, buxhetimin, praktikave dhe mbikëqyrjen e programeve që synojnë përfshirjen sociale dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

# LOT III - Llojet e Aktiviteteve (sugjerime)

- ✓ Ofrimi i programeve të punësimit me mbështetje, aftësimit dhe rehabilitimit për punë
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit për përfshirjen në jetën aktive sociale të PAK dhe familjet e tyre
- ✓ Përfshirje e trajnerëve dhe mentorëve për këshillimin, vlerësimin e aftësive profesionale, dhe gjetjen e punës për PAK;
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit, trajnime për punëdhënësit për përshtatje të arsyeshme të vendit të punës për PAK
- ✓ Programe novatore punësimi, trajnimi dhe vetëpunësimi për PAK
- ✓ Blerje e pajisjeve të nevojshme për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve, duke siguruar që këto investime të kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat e Lotit 3.

Prezantim i kriterëve dhe  
procedurave të aplikimit

# Kush mund të aplikojë?

Për të tre lotet, të drejtë aplikimi kanë:

- ✓ **Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)**
- ✓ **Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e targetuara)**
- ✓ **Ndërmarrjet sociale**



# Kush mund të aplikojë?

## Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)/ndërmarrjet sociale:

- Të jetë person juridik aktiv.
- Të jetë organizatë jofitimprurëse, e regjistruar dhe që vepron ligjërisht në Shqipëri (në përputhje me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001).
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në bashkitë e targetuara.
- Në rastet kur OSHC është aplikanti kryesor (Lead Applicant), duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikuesin(ët) (co-applicant(s)), jo duke vepruar si ndërmjetës;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në zbatimin e projekteve të ngjashme

**Shënim:** Në rast aplikimi të suksesshëm, aplikanti(ët) duhet të hapin një llogari bankare të veçantë në lekë për të gjitha transaksionet në këtë Thirrje).

# Kush mund të aplikojë?

## Bashkitë:

- Të jetë një nga 19 bashkitë e targetuara.
- Në rastet kur bashkia do të jetë aplikanti kryesor (Lead applicant), duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikuesin(ët) (co-applicant(s)), jo duke vepruar si ndërmjetës;

**Shënim:** Në rast aplikimi të suksesshëm, aplikanti(ët) duhet të hapin një llogari bankare të veçantë në lekë për të gjitha transaksionet në këtë Thirrje).

# Kohëzgjatja dhe vendodhja e zbatimit

**Kohëzgjatja e projekteve për çdo LOT nuk mund të jetë më e pak se 8 (tetë) muaj dhe jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.**

**Vendndodhja e zbatimit të projekteve (19 bashki):** Prrenjas, Gjirokastrë, Vorë, Mallakastër, Cërrik, Librazhd, Shijak, Kavajë, Kurbin, Kukës, Krujë, Pogradec, Korçë, Kamëz, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Durrës dhe Tiranë

# Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

## LOT 1, 2 dhe 3:

Granti mund të jepet një projekt të zbatuar **nga një entitet**, ose **nga dy ose më shumë entitete (konsorcium)** që plotësojnë kushtet e thirrjes si dhe mund të përfshijnë **një ose më shumë se një nga bashkitë e targetuara**.

Në çdo rast, projektet e propozuara do të duhet të demonstrojnë partneritet dhe qasje të integruar në zbatim si dhe të kontribuojnë në forcimin e ndërveprimit mes aktorëve në nivel lokal.

**Inkurajohen aplikimet e përbashkëta ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), sipërmarrjeve sociale dhe Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV).**

# Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

LOT 1, 2 dhe 3:

## Aplikime nga një entitet i vetëm

- Aplikantët që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë, mund të aplikojnë në cilindo nga tre LOT-et, por nuk mund të paraqesin më shumë se një (1) propozim.
- Të njëjtat entitete mund të aplikojnë si bashkë-aplikues (co-applicant) në maksimumi dy (2) propozime të tjera.

# Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

## LOT 1, 2 dhe 3:

### Aplikimet nga dy ose më shumë entitete (konsorcium) :

- Aplikimet e përbashkëta mund të kenë vetëm një (1) aplikant kryesor dhe maksimumi dy (2) bashkë-aplikues
- Një entitet i kualifikuar mund të veprojë si aplikant kryesor vetëm për një LOT dhe mund të aplikojë si bashkë-aplikues për maksimumi 2 propozime të tjera.
- Çdo entitet mund të aplikojë si aplikant kryesor ose bashkë-aplikues por nuk mund të paraqesë më shumë se 3 propozime në total.
- I njëjti entitet mund të përfitojë maksimumi një grant si aplikant kryesor dhe maksimumi dy grante si bashkë-aplikues.

Aplikanti kryesor është entiteti që dorëzon formularin e aplikimit. Nëse përzgjidhet për grant, aplikanti kryesor do të bëhet përfituesi i grantit, identifikuar si grantmarrës.

Bashkë -aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë siç zbatohen për aplikantin kryesor .

# Alokimi Financiar

## LOT 1, 2 dhe 3:

### Fondi financiar për lote

Shuma e alokuar për LOT është:

LOT I – 660 000 euro

LOT II – 290 000 euro

LOT III – 250 000 euro

UNDP-ja rezervon të drejtën të mos përdorë të gjithë fondin në dispozicion.

UNDP rezervon të drejtën për të transferuar fondin nga një LOT në tjetrin bazuar në cilësinë e propozimeve të marra. *(vlera më e mirë financiare - rezultate / kosto efektive).*

### Buxheti për grant

- Shuma minimale: 60,000 euro (rreth 6,024,000 lekë)
- Shuma maksimale: 200 000 euro (20 080 000 lekë).

Shuma e mbështetjes financiare **do të disbursohet në lekë në bazë të kursit të këmbimit EUR/ALL** në momentin që shuma do t'i transferohet aplikuesit kryesor.

Mbështetja financiare do të mbulojë **100% të kostove të pranueshme** (Nuk kërkohet bashkëfinancim).

Buxheti i propozimit duhet të hartohet në **lekë**.

**Nën-grantimi nuk lejohet**

# Kostot e papranueshme – Të gjitha LOTET

- ✓ Kostot e zhvillimit të planeve pa rezultate specifike për përfituesit e synuar.
- ✓ Kostot indirekte të zhvillimit të kapaciteteve (Megjithatë, këto kosto mund të planifikohen dhe të përfshihen në kostot direkte të projekt-propozimit)
- ✓ Penalitete dhe gjoba të vendosura nga autoritetet qeveritare ose të shkaktuara si rezultat i mosmarrëveshjeve ligjore me palët e treta
- ✓ Shpenzime të paparashikuara, të paspecifikuara në buxhetin e projekt propozimit.



# Kostot e papranueshme – Të gjitha LOTET

- ✓ Në përgjithësi, kostot për aktivitetet që nuk kontribuojnë në arritjen e objektivave të kësaj thirrjeje për projekt propozime
- ✓ Borxhet dhe tarifat përkatëse (interesi)
- ✓ Detyrimet financiare ose detyrimet e mundshme financiare në të ardhmen
- ✓ Kostot e aktiviteteve të financuara nga një projekt tjetër
- ✓ Kostot që lidhen me rinovimin ose pajisjen e objekteve.
- ✓ Prokurimi i pajisjeve që nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat e Thirrjes për Projekt Propozime (LOT 3)

# Konsiderata të tjera financiare - Të gjitha LOTET

Kostot për trajtimin e barrierave të pjesëmarrjes për punëkërkesit **nuk duhet të kalojnë standardet e vendosura me vendime të Këshillit të Ministrave:**

V endim nr. 401, datë 19.6.2024 “ *Për përcaktimin e procedurave, kriterëve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrit social*”

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/06/19/401/1891acb0-eb8d-43bd-a69b-f9b853efeae6;q=riintegrim%20social%20nxitje%20pu>

## Për grupin e synuar të PAK:

**Akomodim i arsyeshëm.** Deri në 20% të shumës së grantit mund të përdoret për të financuar shpenzimet që lidhen me akomodimin e arsyeshëm dhe që ndihmojnë në ofrimin e trajnimit ose këshillimit.

Akomodimet e arsyeshme përfshijnë mjetet e vendit të punës, literaturën/informacionin e punës, asistentët personalë në vendin e punës, interpretimin e gjuhës së shenjave si dhe transportin e përshtatshëm dhe aksesin në vendin e punës.

# Paketa e aplikimit - Të gjitha LOTET

## Paketa e aplikimit:

- a. Profili i aplikantit (shtojca 1)
- b. Formati i project propozimit të UNDP-së (shtojca 2)
- c. Formati i buxhetit (shtojca 3)
- d. Deklarata e qëllimit të aplikantit në rastin e aplikimeve të vetme dhe të aplikantit kryesor në rast të aplikimeve të përbashkëta për projektin e propozuar (shtojca 4)
- e. Marrëveshja e partneritetit (MoU) ndërmjet aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve (*mbi rolet, përgjegjësitë dhe menaxhimin financiar për projektet e propozuara, në rastin e aplikimeve të përbashkëta*) (shtojca 5)

**Dokumentet mbështetëse** sipas udhëzimeve të dhëna (OSHC/Bashkitë)

**Informacioni dhe formatet përkatëse të "Thirrje për propozime"** në: <https://www.undp.org/albania/news/call-proposals-framework-eu-labour-market-inclusion-project>

# Udhëzime për aplikimet - Të gjitha LOTET

- ✓ Përdorni formatet e paketës së aplikimit dhe ndiqni udhëzimet e dhëna në Dokumentin e Thirrjes për Propozim
- ✓ Përgatitni projekt propozimin në anglisht
- ✓ Përgatitni buxhetin në lekë
- ✓ Siguroni dokumentet mbështetëse sipas udhëzimeve (OSHC/Bashkitë)
- ✓ **Propozimet e plota** duhet të dorëzohen të nënshkruara/vulosur dhe të skanuara, elektronikisht
- ✓ **Formati i propozimit dhe formati i buxhetit** duhet të dërgohen në **PDF (nënshkruar dhe vulosur) dhe në formatin e paketës** (Ms Word, Ms Excel)
- ✓ **Dokumentet mbështetëse** duhet të dorëzohen në kopje të skanuara.
- ✓ Kontrolloni me kujdes listën kontrolluese administrative dhe të pranueshmërisë për të siguruar që propozimi është në përputhje me kriteret e verifikimit për të vazhduar me fazën e vlerësimit.
- ✓ Ndiqni me kujdes Kriteret e Vlerësimit për t'u siguruar që propozimi i përgjigjet çdo kategori të Kriterëve të Vlerësimit
- ✓ Aplikimet jo të plota, mund të refuzohen

# Kriteret e Vlerësimit- Të gjitha LOTET

| Kategoritë e Vlerësimit                                                         | 100 Pikë |
|---------------------------------------------------------------------------------|----------|
| 1. Kapaciteti operacional dhe financiar i aplikantëve                           | 30 pikë  |
| 2. Rëndësia e projekt propozimeve, metodologjisë, qasjes dhe planit të zbatimit | 40 pikë  |
| 3. Qëndrueshmëria dhe risitë në projekt propozime                               | 15 pikë  |
| 4. Buxheti dhe efektiviteti i kostimit të veprimeve                             | 15 pikë  |

# Kriteret e Vlerësimit- Të gjitha LOTET

|          |                                                                                                     |                |
|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| <b>1</b> | <b>Kapaciteti operacional dhe financiar i aplikantëve</b>                                           | <b>30 pikë</b> |
| 1.1      | Përvojë në menaxhimin dhe koordinimin e projekteve të punësimit dhe zhvillimit të aftësive          | 5              |
| 1.2      | Përvojë dhe ekspertizë e stafit të propozuar, të përfshirë drejtpërsëdrejti në zbatimin e projektit | 10             |
| 1.3      | Demonstrim i kapaciteteve ligjore dhe financiare në menaxhimin e projekteve                         | 10             |
| 1.4      | Relevanca e demonstruar për partneritetin e propozuar                                               | 5              |
| <b>2</b> | <b>Rëndësia e projekt propozimeve, metodologjisë, qasjes dhe planit të zbatimit</b>                 | <b>40 pikë</b> |
| 2.1      | Rëndësia dhe përfrimi me kontekstin                                                                 | 10             |
| 2.2      | Metodologjia e propozimit dhe qasja gjithëpërfshirëse                                               | 20             |
| 2.3      | Efektiviteti i aktiviteteve të propozuara dhe plani i punës                                         | 10             |
| <b>3</b> | <b>Qëndrueshmëria dhe risitë në projekt propozimit</b>                                              | <b>15 pikë</b> |
| 3.1      | Niveli i replikimit dhe novacionit në qasjen e propozuar të zbatimit të projektit                   | 7              |
| 3.2      | Qëndrueshmëria e rezultateve përtej afatit kohor të projektit                                       | 8              |
| <b>4</b> | <b>Buxheti dhe efektiviteti i kostimit të veprimit</b>                                              | <b>15 pikë</b> |
| 4.1      | Qartësia dhe përputhshmëria e buxhetit të projektit                                                 | 7              |
| 4.2      | Efektiviteti i kostove                                                                              | 8              |

# Dorëzimi i aplikimeve - Të gjitha LOTET

Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve është **30 Shtator 2024**.

Propozimet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën e emailit: [eu4lmi.al@undp.org](mailto:eu4lmi.al@undp.org)

Subjekti i emailit duhet të jetë: **EU4LMI Thirrje për propozime – [specifiko LOT] - [emri i aplikantit]**

Email i aplikimit duhet të përmbajë **të gjitha shtojcat e paketës së aplikimit dhe dokumentet mbështetëse.**

Dokumentet duhet të dorëzohen bashkangjitur (attachments) **në email.**

Google links, drive links që kërkojnë doënload të dokumenteve **nuk do të pranohen.**

# Sesionet informuese / Pyetje dhe Përgjigje

Prezantimi i sesionit informues (ppt) do të gjendet në faqen e internetit të UNDP-së

Të gjitha pyetjet e mundshme mund të dërgohen deri më **09 shtator 2024** vetëm në këtë email: [eu4lmi.al@undp.org](mailto:eu4lmi.al@undp.org)

Përgjigjet për pyetjet e dërguara do të përgatiten deri më **16 shtator 2024**

Të gjitha Pyetje dhe Përgjigje do të publikohen në faqen e internetit të UNDP-së



# Tabela informuese mbi afatet

|                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| <b>Sesion informues (webinar):</b>                                                                               | 27 Gusht 2024 online                                                                                                                                                                                                                                                              | 11:00                                              |
| <b>Sesion informues (webinar):</b>                                                                               | 29 Gusht 2024 online                                                                                                                                                                                                                                                              | 11:00                                              |
| <b>Sesion informues (Tiranë):</b>                                                                                | 04 Shtator 2024, Europe House                                                                                                                                                                                                                                                     | 11:00                                              |
| <b>Sesione informuese të dedikuara</b><br>( Drejtoritë Rajonale të AKPA)<br>mbi programin e nxitjes së punësimit | 02 Shtator 2024, Drejtoria Rajonale Vlorë<br>03 Shtator 2024, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë<br>10 Shtator 2024, Drejtoria Rajonale Shkodër<br>12 Shtator 2024, Zyra e Punës Pogradec<br>13 Shtator 2024, Drejtoria Rajonale Elbasan<br>16 Shtator 2024, Drejtoria Rajonale Kukës | 11:00<br>11:00<br>11:00<br>11:00<br>10:00<br>11:00 |
| <b>Afati i fundit për pyetje për informacion/sqarime shtesë</b>                                                  | <b>09 Shtator 2024</b>                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                    |
| <b>Afati i fundit në të cilën janë dhënë sqarimet nga UNDP</b>                                                   | <b>16 Shtator 2024</b>                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                    |
| <b>Afati i fundit për dorëzimin e Aplikimeve</b>                                                                 | <b>30 Shtator 2024</b>                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                    |
| <b>Vlerësimi i projekt propozimeve të dorëzuara</b>                                                              | Tetor 2024                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                    |
| <b>Njoftimi i rezultateve</b>                                                                                    | Nëntor 2024                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                    |
| <b>Nënshkrimi i marrëveshjeve</b>                                                                                | <b>Dhjetor 2024</b>                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                    |